



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 179, datë 26.09.2019

PËR
CAKTIMIN E NJË ANËTARI NË KOMISIONIN PËR MBROJTJEN E GJYQTARËVE
NGRITUR PRANË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 20 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 564, datë 31.07.2019 "Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij”, mbi propozimin e Komisionit për Planifikimin Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Caktimin e z. Medi Bici si anëtar, njëkohësisht dhe kryetar, i Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, për një mandat dyvjeçar.
2. Ngarkohet Kryetari i Komisionit, për të kërkuar nga institucionet e parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 564, datë 31.07.2019, caktimin e përfaqësuesve të tyre në përbërje të Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve.
3. Këshilli i Lartë Gjyqësor garanton mbështetjen e duhur organizative dhe administrative për realizimin e funksionit të Komisionit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR